

REPUBLIKA E KOSOVE
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLICA OF KOSOVA

C.nr.18/2010

GJYKTA THEMELORE MITROVICE (ne objektin e deges se kesaj gjykate ne Vushtrri), gjyqtari Skender Shala, me qeshtjen juridike kontestimore te paditeses , te cilen e perfaqeson i autorizuari , sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit nga Mitrovica Rr nr per borxh, ne seancen pergatitore te mbajtur me dt. 24.10.2013, ne prezence te te autorizuarit te paditeses , e ne mungese te te paditurit , bie kete:

A K T G J Y K I M P E R S H K A K
T E M U N G E S E S

APROVOHET kerkespadia e paditeses e bazuar dhe **OBLIGOHET** i padituri Rasim Mikullovc i nga Mitrovica rr "M " nr. , qe ti paguaj paditeses ne emer te borgjit shumen prej 424,89 Euro, me kamate prej 3.5% , te cilen e paguajne bankat komerciale duke filluar nga dita e parashtrimit te padise e deri ne ditën e pageses definitive si dhe shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 30 euro, ne afat prej 7 (shtate) ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketije aktgjykimi, nen kercenim te permbarimit te dhunshem.

A r s y e t i m

Paditesja permes te autorizuarit te saj ka ushtruar padi ne kete gjykate dhe ka kerkuar qe gjykata ta obligoj te paditurin qe paditeses t'ia paguan shumen prej 424.89 Euro, me kamat ligjore prej 3.5%, duke filluar prej dates se parashtrimit te padise e gjere ne ditën e pageses definitive si dhe t'ia paguaj shpenzimet e perocedures kontestimore.

Gjykata caktoj seancen e shqyrtimit pergatitor per dt. 24.10.2013, ne ora 13:00 dhe per kete palet kane qene te ftuara me rregull. Ne seance prezentoj i autorizuari i paditeses kurse i padituri edhe pse eshte ftuar me kohe dhe ne menyre te rregullt, i njeiti nuk i'u pergjigj fteses dhe nuk prezentoi ne séance gjere ne perfundimin e saj dhe mungesen nuk e ka arsyetuar, qka u konstatua ne baze te fletktheses te kthyer nga sherbimi I dorezimit te kesaj gjykate e dt. 14.10.2013 dhe nuk e ka kundërshtuar me parashtrese kerkespadine e paditeses.

Ne kete séance i autorizuari i paditeses propozoj Gjykates qe seanca te mbahet ne mungese te te paditurit, per shkak se i njejté eshte ftuar me kohe dhe ne menyre te rregullt dhe mugesen nuk e ka arsyetuar si dhe te bie akgjykim per shkak te mungeses.

Me qenese kerkespadija bazohet ne fakte te cekura ne padi, ndersa keto fakte nuk jane ne kundershtrim me provat te cilat i autorizuari i paditeses i ka prezentuar, gjykata gjeti se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi e konform nenit 151.1 te Ligjit per proceduren kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore u muar konform nenit 452.1 te LPK-se, ashtu qe te padituren e obligoj qe paditeses t'ia paguaj shpenzimet e procedures kontestimore dhe ate taksen per padi dhe vendim gjyqesor, shumen prej 30 euro, konform Udhezimit Administrativ te KGJK per Tarifat e Taksave Gjyqesore nr. 2008/02.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.18/10, te dt.24.10.2013.

Gjyqtari,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE :Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimit e verteton: